


RELACION TEKNIK

Objekti “Sistemim asfaltim rrugët e Rajonit Jugor Gjirokastër”


PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Projekt – zbatimi i objektit “Sistemim asfaltim rrugët e Rajonit Jugor Gjirokastër” është hartuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Projekt – zbatimi ka për qëllim rehabilitimin e rrugës së fshatit Vajkan – Kolonjë. Projekti parashikon ndërhyrje në shtresat rrugore dhe sinjalistikë.

Ky aks rrugor është shumë i rëndësishëm pasi përshkon disa njësi administrative me zhvillim të lartë bujqësor. Segmenti shërben edhe si rrugë alternative për lidhjen e dy qyteteve, Lushnje dhe Fier.



Ky segment rrugor ku do të ndërhyet ka një gjatësi prej 6.5 km me dy sense lëvizje, me gjerësi të shtresës asfaltike 6 m, si dhe 0.5 m bankinë në të dy anët.



Rruga kalon nëpër një zonë kodrinore. Segmenti që do të nënshtrohet ndërhyrjes fillon në afërsi të fshatit Vajkan në degëzimin e rrugës provizore që lidhte superstradën Lushnje – Fier, pa u ndërtuar nyja e ByPass-it të Fierit, dhe vazhdon në drejtim të fshatit Kolonjë për një gjatësi prej rreth 6.5km.

Shtresat asfaltike janë të dëmtuara, me gropëzime, çedime, rrjetëzime etj.

Shtresa e asfaltobetonit është e konsumuar dhe e rrjetëzuar në të gjithë sipërfaqen. Shtresa e binderit është e dëmtuar në mbi 50% të sipërfaqes së asfaltuar.

Paraprakisht, theksohet se paketa e shtresave është ruajtur si ajo ekzistuesja, 4cm asfaltobeton dhe 6cm binder.

Ndërhyrja parashikon gërmimin e shtresave të dëmtuara për një gjatësi prej rreth 3km. Vlerësohet se në rreth 15 % të sipërfaqes së kësaj gjatësie ka nevojë të ndërhyet në nënshtresat e rrugës. Gjithsesi pas heqjes së shtresave të dëmtuara do të përcaktohet sipërfaqja dhe thellësia e saktë e ndërhyrjes në shtresën e stabilizantit dhe nënshtresat e tjera.

Kanalet e kullimit janë totalisht të bllokuara dhe kanë nevojë për pastrim.

Më tej, do të bëhet kompletimi me sinjalistikë horizontale e cila konsiston me vijëzim gjatësor me bojë termoplastike me gjerësi 15cm për vijën e mesit si dhe me vijëzimin gjatësor anësor me bojë bikomponente me gjerësi 12cm. Për pozicionimin e saktë të vijave të ndërprera, zbatuesi i punimeve duhet ti referohet me përpikmëri kërkesave të Kodit Rrugor të RSH-së, rregullores për zbatimin e kodit rrugor dhe manualit të sinjalistikës rrugore.

Sinjalistika vertikale do të jetë si plotësim i asaj ekzistuese.

Plani i menaxhimit të trafikut do të jetë i ndryshueshëm sipas përparimit të punimeve, që do të thotë që rrugët alternative për devijimin e trafikut do të ndryshojnë në vazhdimësi deri në përfundimin e punimeve. Ai do të përgatitet nga kontraktori në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe do të miratohet nga Autoriteti Kontraktor në Bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë.

Grupi i punës: